

20251923936

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË SIGURISË SOCIALE PËR PERSONAT E
MOSHUAR

Neni 1

Në Ligjin e Sigurisë Sociale për Personat e Moshuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.104/19), në nenin 13, paragrafi 2 fjalët: “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët: “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Neni 2

Në nenin 14 fjalët: “e Punës dhe e Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve”.

Neni 3

Komisioni juridik-ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është i autorizuar të përpilojë tekst të rafinuar të Ligjit të Sigurisë Sociale për Personat e Moshuar.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.